

STATUT I SHOQERISE

TIPAR SH.P.K

Ky Statut do te konsiderohet se inkorporon dhe/ose perfshin Aktin e Themelimit te Shoqerise , organizimi dhe funksionimi I te ciles rregullohet ketu.

Sot, me 01 Dhjetor 2023, personat e mëposhtem :

Z. Elios Kovaci, atësia Gjergji shtetas shqiptar, lindur më 06.06.1989 në Tirane , banues në Tiranë, njësia Bashkiake nr 1, rruga Ali Demi ,Nd. Nr A8, Ish gjeologjiku , me nr ID I90606094W , madhor e me zotësi të plotë për të vepruar,pa kufizime te kompetencat e administrimit.

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja

Neni 1

Data e Themelimit,Emri dhe Themeluesi

Sot më 01 Dhjetor 2023 une , themeluesi I vetem ,kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregëtar “**TIPAR**” **SH.P.K.**

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtem:

Aktivitete tregetare ne fushen e arredimit, mobilimit, arkitektures. Import -eksport mallra te ndryshme. Sherbime te ndryshme ne organizim festa dhe evenete.



Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërise do të jetë *e pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.*

Neni 4

Selia

Selia e shoqërise do të jetë në adresën , njësia Bashkiake nr 1, rruga Ali Demi ,Nd. Nr A8, Ish gjeologjiku, Tiranë.

Me Vendim të Administratorit, Shoqëria mund te celë degë dhe /ose zyra perfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

KREU II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar


Kapitali fillestar I shoqërisë është 1000,00 (njëmij, presje zero) lekë, Pjesëmarrja e themeluesit është

1-Ortaku I vetem themelues Elios Kovaci zotëruesh i 1(një) pjese të kuotave me vlerë 1000,00(njemije,presje zero) lekë e barabarte me 100% te kapitalit të shoqerisë.

Neni 6

Zmadhimi ose zvogëlimi I kapitalit

Kapitali I shoqërise mund të zmadhohet ose zvogëlohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.



Neni 7

Transferimi I kapitalit

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet :

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitali themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitali themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi I vetëm vendimmarrës I shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi I vetëm vendimmarrës I shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara me ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse përmarrjen e vendimeve per shoqerinë për cështjet e mëposhtëme :

- a.Përcaktimin e politikave tregtare te shoqërisë;
- b.Ndryshimet e statutit ;
- c.Emërimin e shkarkimin e administratorëve ;
- ç.Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël te autorizuar ;

- d.Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat C dhe të kësaj pike ;
- dh.Mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë ;
- e.Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë ;
- ë.Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit ;
- f.Pjesëtimin e kuotave dhe anullimin e tyre ;
- g.Përfaqësimin e shoqërise në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve ;
- gj.Riorganizimin dhe prishjen e shoqërise ;
- h.miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë ;
- i.shperndan fitimet vjetore
- j.çështje të tjera te parashikuara me ligj ose statut.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme , në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër ose nga një person i tretë.

Administratori I shoqërisë mund të veprojë si përfaqësues I ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Neni 9

Mënyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë së Pergjithshme

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose ,nëse parashikohet nga statuti , me njoftim nëpërmjet postes elektronike. Njoftimi me shkresë ose mesazh duhet të permbajë vendin,datën,orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dergohet të gjithë ortakeve, jo me vonë se 7 ditë para datës se parashikur për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 te ketij nenii, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastet e marjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marre vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me te drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 per qind te kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje , të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregëtaret dhe Shoqëritë Tregëtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë ,apo mjete elektronike ,sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur më lart, asambleja mblidhet përseni jo më vonë se 30 ditë, me të njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e Vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarres, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të rregjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërise.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë votash të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si : përcaktimi I politikave tregtare të shoqërise ; emërimin e administratorëve ; emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar ; përcaktimin e shpërblimeve ; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; perfaqësimin në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve ; miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë te drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për : vlerësimin e veprimtarisë së tij ; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij ; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria ; dhënien ose jo te përfitimive te reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interesë si edhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorëtë shoqërisë. Afati I emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personit e mëposhtëm caktohet administrator I parë I shoqerisë për një mandat 5 (pesë) vjecar emërimi :

Z. Elios Kovaci, atësia Gjergji shtetas shqiptar, lindur më 06.06.1989 në Tirane, banues në Tiranë, njësia Bashkiake nr 1, rruga Ali Demi ,Nd. Nr A8, Ish gjeologjiku ,me nr ID 190606094W , ,madhor e me zotësi të plotë për të vepruar,pa kufizime te kopetencat e administrimit.

KREU IV

Viti Financiar-ekspertët

Neni 14

Viti finanziar

Viti finanziar I shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor. Përashtimisht ,viti i parë finanziar fillon nga data e rregjistrimit të shoqerisë në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit të biznesit dhe mbyllet në 31 dhjetor.

Neni 15

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithe dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare së shoqerisë , atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara perj tij në rastet kur ai është I ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël I autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të

cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorezojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V

Prishja – Riorganizimi I Shoqërise

Neni 16

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërise mund të bëhet në cdo kohë : kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj ; me vendim të asamblesë së Ortakëve ; me hapjen e procedurave të falimentimit ; në përputhje me pikën 3 në nenit 43 të ligjit 9723/2007 ; me vendim te gjykatës.

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në cdo document të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që jane emëruar nga ortakët.

Nëse ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve , brenda 30 ditëve pas prishjes, cdo person I interesuar mund ti drejtohet gjykatës ,për të caktuar një likuidues.

Neni 17

Riorganizimi I Shoqërise , bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet ,bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregëtarët dhe shoqeritë tregëtare “.

Neni 18

Baza ligjore

Shoqërisa do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregëtaret dhe shoqeritë tregëtare”, të Kodit Civil dhe cfarëdo ligji tjeter specific në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti , si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërise dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


Per kryerjen e te gjithe procedurave te nevojshme per rregjistrimin e Shoqerise ne rregjistrin tregëtar pranë QKB autorizoj Znj. Zinaida Leskaj.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

TË SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR

“TIPAR” SHPK

Elios Kovaci

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Elios Kovaci". Below the main name, there is a smaller, stylized signature that looks like "Elios" or "EJ".